# KOMUNIKATË PËR WEB

## Statistika e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve, Dhjetor 2023

15.02.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat preliminare[1] në baza mujore për Lindjet, Vdekjet, Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet për muajin Dhjetor 2023.

Këto të dhëna publikohen duke u bazuar në të dhëna administrative.

Sipas dispozitave ligjore mbi udhëheqjen e regjistrave themeltarë për Lindjet, Vdekjet, Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet, rastet regjistrohen në mënyrë të obligueshme në regjistrat e lartë-cekur, në vendin ku ka ndodhur ngjarja, pa marrë parasysh se personat me të cilët lidhet ngjarja, vendbanimin e përhershëm e kanë në atë vend, ose në ndonjë vend tjetër.

Në muajin Dhjetor 2023 janë regjistruar 2 026 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre lindjeve të regjistruara, 1 061 lindje janë meshkuj dhe 965 lindje janë femra.

Ndërsa, janë regjistruar gjithsej 877 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej vdekjeve të regjistruara, 459 janë meshkuj dhe 418 janë femra.

Në muajin Dhjetor 2023 janë regjistruar gjithsej 1 618 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës), kurse shkurorëzime të ndodhura në Kosovë janë regjistruar 131 raste.

ASK-ja do të vazhdojë me grumbullimin e të dhënave përmes pyetësorëve të veçantë statistikorë, për Lindjet DEM-1, Vdekjet DEM-2, Kurorëzimet DEM-3, dhe Shkurorëzimet SHK-1, sikurse deri më tani. Grumbullimi i të dhënave vazhdon të bëhet çdo muaj dhe do të shërbejë për krijimin e bazës së të dhënave, si dhe krahasimin me të dhënat administrative.

Burimi i të dhënave të këtij publikimi është Agjencia e Regjistrit Civil të Kosovës (ARC).

[1] Shfrytëzuesve të të dhënave u rekomandohet, që këto të dhëna të merren si të dhëna preliminare dhe jo si të dhëna përfundimtare.